

ARSYET PSE DUHET TË KRYHET TESTI (ANALIZA) E HIV/SIDA

ËSHTË TEST FALAS DHE KONFIDENCIAL

- Testimi për HIV/SIDA në qendrat e këshillimit dhe testimit vullnetar (VCT) është falas dhe konfidencial. Kjo do të thotë që punonjësit e shëndetësisë që punojnë në këto qendra nuk do t'i tregojnë njerëzve të tjerë rezultatet e testit. Ata do ta ruajnë këtë informacion në një vend të sigurtë. Çdo njeri ka të drejtën për të kryer një test të HIV-it falas, dhe asnjëri nuk do t'i mësojë rezultatet e testit tuaj.
- Tek qendrat e këshillimit dhe testimit vullnetar ju do të keni një përkujdesje të plotë, përfshirë këtu edhe infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST). Ju gjithashtu, jeni të lirë të bëni pyetje rreth shëndetit tuaj seksual.
- Në këto qendra do t'ju ofrohet këshillim para testimit në të cilin ju diskutoni se çfarë është testimi, dhe çfarë do të ndodhë kur ju të merrni rezultatet e testit. Qëllimi i këtij këshillimi është t'ju ndihmojë rreth testimit për HIV-in. Ju mund të zhvilloni disa takime përpara se të merrni ndonjë veprim. Ju mund të diskutoni me punonjësit e qendrës se çfarë mund të ndodhë nëqoftëse ju merrni një rezultat pozitiv të HIV-it.
- Pavarësisht nga rezultatet e testit të HIV-it, punonjësit e qendrave do t'i përgjigjen çdo pyetjeje që mund të keni, nëse ato nuk mundën, ata do t'ju referojnë tek dikush që mund t'ju ndihmojë.



Mesazhe nga punonjëset e seksit:

“Në vendet e zhvilluara puna e seksit është një alternativë, ndërsa në vendet e varfëra si Shqipëria është e vetmja mundësi për jetesë.”

“Punonjëset e seksit sulmohen nga policët dhe klientët rrihen dhe keqtrajtohen – gjithashtu policët kërkojnë favore apo “shërbim” falas nga ata.”

“Pranoni të drejtat e punonjësve të seksit – shoqëria duhet të na pranojë. Ne kërkojmë të na mbrohet shëndeti ynë.”

“Na dekriminalizoni, dekriminalizoni komunitetin tonë dhe jepini fund kësaj errësire dhe rreziqeve që i kanosen kësaj ekonomie informale... gjëja e vetme që ky ndalim sjell është rritja e dhunës, degradimit dhe abuzimit të shirtërave të përbuzur që me guxim kanë zgjedhur të bëjnë seks për para. Ne banojmë në të njëjtat komunitete, fëmijët tanë ndjekin të njëjtat shkolla, ne votojmë, ne arrestohemi çdo ditë – ne jemi nënat, bijat, motrat, fqinjët dhe miqtë.”

Për më shumë informacione kontaktoni:

AKSION PLUS
Prapa Ambasadës Amerikane;
Tiranë
Cel. 0692066359
E-mail:
gencaxionp@albmil.com
Website www.aksionplus.net



Botim i Shoqatës
“Aksion Plus”



Të mbrosh VETEN dhe PARTNERIN

FLETUSHKË PËR PUNONJËSET E SEKSIT

Me mbështetjen e:



dhe



Tiranë, dhjetor 2010

Në qoftë se punoni si punonjëse seksi, ju duhet të dini si të mbroheni nga infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST). Seksi më i sigurtë është kur ju mbron veten tuaj dhe të tjerët nga IST. Ju mund të merrni IST kur ju kryeni kontakt seksual pa prezervativ.

PËRDORIMI KORREKT I PREZERVATIVIT

Që të mbron veten dhe partnerin, ju duhet të dini të përdorni siç duhet prezervativin dhe lubrifikantet.

Mos përdorimi i prezervativit sjell për ju:

- Rrezikun e transmetimit të HIV/SIDA
- Infeksionet seksualisht të transmetueshme si: klamidia, gonorea, sifilizi, hepatiti B dhe C, trikomonas.
- Shtatëzanitë e padëshiruara

Nëse jeni një punonjëse seksi ju keni të drejte të:

- Punoni në kushte të mira dhe të sigurta
- Të refuzoni klientin
- Të refuzoni të bëni aktivitete të ndryshme seksuale kundër dëshirës suaj.

Dhe askush nuk mund të:

- T'ju dhunojë ju të merrni droge apo alkool
- Të punoni në kushte jo të sigurta dhe pa prezervativ
- Të vendosë se kur duhet të shkoni të vizitoheni, apo të kryeni testet e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST) dhe HIV/SIDA.

SI INFEKTOHET NJË NJERI ME HIV?

Ka disa mënyra se si mund të infektosh nga HIV:

- Të kryesh marrëdhënje të pambrojtura seksuale, vaginale ose anale, me një person të infektuar nga HIV. HIV-i transmetohet nëpërmjet spermës apo lëngjeve vaginale.
- Të shkëmbesh shiringën e drogës me një njeri të infektuar – HIV-i transmetohet me anën e gjakut që është në agjen e shiringës.
- Një grua e infektuar mund t'ia transmetojë HIV-in foshnjës së saj gjatë shtatzanisë, lindjes apo ushqimit me gji.
- Disa njerëz infektohen nga virusi me anën e dhurimit të gjakut ose produkteve të tij. Por kjo mënyrë transmetimi thuhet se është eliminuar tashmë sepse gjaku i dhuruar kontrollohet.

HIV-i nuk transmetohet nga:

- Lotët, pështyma, djersa, urina apo feçet sepse sasia e HIV-it në to është e vogël në to për të shkaktuar infeksion, por po të bien në kontakt me gjakun e personit të infektuar, këto lëngje bëhen burim infeksioni.
- Nga kafshët e ndryshme shtëpiake
- Nga mushkonja apo insekte të tjera
- Gjatë përqafimit apo dhënies së dorës
- Gjatë ngrënies
- Në ambjente publike si banjo, dush, vendet e punës, taksi, autobusë.

DROGA duhet të përdoret gjithmonë me shiringa me një përdorim, dhe të mos shkëmbehet shiringa me përdorues të tjerë.

Tani për tani infeksioni HIV/SIDA është i pashërueshëm

PRANDAJ

- Masat parandaluese janë të domosdoshme
- Kur ke kontakt me situata të rrezikshme që mund të marrësh HIV, duhet të ekzaminohesh pas 3-6 muajsh nga situata dhe në qoftëse je sero-pozitiv duhet të mjekohesh rregullisht që të përmirësohet dhe zgjatet jeta.

MBRO VETEN – MBRO DHE TË TJERËT

SEPSE nga HIV-i infektohen të gjithë pa përjashtim; pa dallim kombësie, feje, moshe seksi, profesioni apo gjendje sociale.

PSE DUHET TË KRYEJ TESTIN E HIV/SIDA?

Të kryesh testin e HIV-it, dhe të njihesh me rezultatet e tij të lejon të marrësh vendimet e duhura në jetën tënde. Këto vendime janë të tuat, vetëm ti mund të vendosësh.

TESTI I HIV-IT TË LEJON TË MËSOSH NËSE JENI HIV POZITIV OSE HIV NEGATIV.